# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-467957**
VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | ‘Do të preferoja të isha në ferr’/ Britania në zi për vdekjen e 12-vjeçares, dyshohet se po përballej me bullizëm |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/25/do-te-preferoja-te-isha-ne-ferr-britania-ne-zi-per-vdekjen-e-12-vjecares-dyshohet-se-po-perballej-me-bullizem/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 25 shtator 2026, 08:08:27 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 25 shtator 2026, 08:04:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 25 shtator 2026, 08:03:00 UTC → 25 shtator 2026, 08:05:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `bd39a002bf3192b86fdcc6d18d0b71a2b673d8d61eaa3ebd08ec2f17ec325586` |
| TEKSTI | `9426e8b35653d96cf2699e12fe8209c750fa2e12b05566216a8193a5081a5721` |
| PAMJA | `26c65a7b1da0572b2d1ffb6408701d2373679b6716bbe425ff6add45ba10a020` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `141617987228efbf342c5607d07d5b5f846b2fdb563220b8bf8c4e07105fc83e` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `03bdce4b1a721a6f1a89a4ef485ddb946ec31f15b1790ea3cb05a93e1803ce0e` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/141617987228efbf342c5607d07d5b5f846b2fdb563220b8bf8c4e07105fc83e`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

BOTA TË FUNDIT

# ‘Do të preferoja të isha në ferr’/ Britania në zi për vdekjen e 12-vjeçares, dyshohet se po përballej me bullizëm

25/09/2026 10:04



**Një ngjarje tragjike ka tronditur Britaninë, pasi 12-vjeçarja Angel Carranza u gjet e pajetë në dhomën e saj të gjumit në shtëpinë e familjes në Poole, Dorset, më 17 mars.**

Vajza, e përshkruar nga familjarët si një “nxënëse model”, dyshohet se po përballej me vështirësi përshtatjeje pas kalimit në një shkollë të re. Miqtë e saj u thanë autoriteteve se Angel kishte pasur probleme me pranimin shoqëror dhe njëra prej tyre pretendoi se ajo ishte ngacmuar nga një grup vajzash.

Pak para vdekjes, 12-vjeçarja thuhet se i kishte thënë një shoqeje se “do të preferonte të ishte në ferr sesa në shkollë”.

Babai i saj, Eliud Matidi, dëshmoi gjatë hetimit të mjekut ligjor në Bournemouth se vajza kishte filluar gradualisht të tërhiqej nga familja dhe shoqëria. Sipas tij, Angel kalonte gjithnjë e më shumë kohë në telefon, duke parë video në YouTube dhe duke luajtur Minecraft.

Trupi i Angel u gjet rreth orës 07:30 të mëngjesit. Gjatë kontrollit të telefonit të saj, autoritetet zbuluan se 12-vjeçarja kishte shkëmbyer mesazhe në Snapchat deri rreth orës 05:00 të asaj dite.

Megjithatë, kontrolli i telefonit dhe tabletit të saj nuk zbuloi prova për ngacmim kibernetik apo kërkime që lidhen me vetëvrasjen. Vajza nuk kishte lënë një shënim dhe, sipas hetimit, nuk kishte treguar te miqtë e saj për ndonjë qëllim të tillë.

Babai i saj tha se kalimi nga shkolla fillore në Akademinë Cornerstone në Hamworthy kishte qenë veçanërisht i vështirë për të.

“Ishte një shkollë shumë më e madhe dhe ajo ngurronte shumë të shkonte. Ajo humbiste shumë orë mësimi dhe performanca e saj akademike u ndikua”, dëshmoi ai. Megjithatë, ai tha se kishte besuar se Angel po i kapërcente vështirësitë, pasi frekuentimi i saj në shkollë ishte përmirësuar dhe ajo kishte krijuar një grup të ri miqsh.

Eliud Matidi e përshkroi vajzën e tij si “dritën” e familjes, duke kujtuar se në shkollën fillore ishte një nxënëse shembullore, e sjellshme dhe nuk kishte shkaktuar probleme.

Ai tregoi gjithashtu se në mëngjesin e 17 marsit ishte përpjekur tri herë ta zgjonte për të shkuar në shkollë, por nuk kishte marrë përgjigje.

Mjeku ligjor i Dorsetit, Brendan Allen, e konsideroi vdekjen e 12-vjeçares si pasojë e varjes, por theksoi se “qëllimi i saj nuk u shpjegua nga provat e paraqitura”.

**Top Channel**

## Bota »

## Kryesore



Mesazhi i presidentit iranian për Trump, Pezeshkian: Ne jemi gati për marrëveshje, SHBA duhet të vendosë për fundin e luftës
07:43

Top Story/ “Kërkoi ekspertim të telefonit jashtë Shqipërisë”, gazetarja Hoxha zbardh detajet nga seanca me dyer të mbyllura, çfarë deklaroi Vlora Hyseni në SPAK
21:21

Fjalimi i Netanyahut në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së, dhjetëra diplomatë lënë sallën: Nëse ka frikacakë të tjerë të largohen tani
22:59

Parashikimi i motit/ Dita e sotme sjell reshje, shtrëngata dhe dëborë në zonat malore
07:05

VIDEO/ Kosova e nis Nations League me këmbë të mbarë, për ‘Dardanët’ vendos Muriqi që ua dedikon golin ish krerëve të UÇK
22:43

## Më të lexuarat

Top Story/ “Kërkoi ekspertim të telefonit jashtë Shqipërisë”, gazetarja Hoxha zbardh detajet nga seanca me dyer të mbyllura, çfarë deklaroi Vlora Hyseni në SPAK

Aksion i policisë në Tiranë, vihen në pranga 8 të kërkuar për krime të rënda, armë, drogë dhe vjedhje

“Dumani përzuri Vlorën nga zyra”, Murrizi bën deklaratën e fortë në Top Story: E nxori nga qershori i 2025

“Burg, burg”, një grup protestuesish përplasen me Çuçin dhe bashkëshorten në kafene, si përgjigjet deputeti i PS dhe Delina Fico

Bllokohen specat dhe açuget/ Jo vetëm perimet, Shqipëria ka probleme edhe me produktet e detit. Bllokohen në Itali

“Lashë në mes përkthimin e librit të ish-shefit të kundërzbulimit të STAS-it”, rrëfimi i Auron Tares: Historia e spiunazhit në Tiranë ia kalon edhe Luftës së Ftohtë

“Goca dhe Gra” rikthehet në ekranin e Top Channel me ndryshime, kush janë moderatoret e sezonit të ri?

“Po si nuk i fiku njeri radarët për mua moj motër”, Kryemadhi batuta dhe ironi për Vlora

Hysenin: Meta i ndizte se kishte hallin e vendit, puthte...

Top Story/ “Mbrojtja do jetë arrogante”, Vangjeli për deklaratën e Vlora Hysenit: Po shantazhon njerëzit me pushtet. Pretendimi i saj për Agasin, i gënjeshtërt

Hetimet dhe masa e sigurisë ndaj Vlora Hysenit, ambasadori i Italisë: Çështjet e bashkëpunimit dypalësh...



Tragjedi në Gaza, shpërthen droni që po përdornin, vriten dy ushtarë izraelitë

25/09 09:50



Përplasje për zgjedhjet në Brazil/ 31 ligjvënës amerikanë akuzojnë administratën Trump për ndërhyrje

25/09 09:47



Trump-Xi me tapet të kuq e banket, por pa marrëveshje për çështjet më të nxehta

25/09 09:41



Shpërthim i fuqishëm në Athinë, shembet një ndërtesë dykatëshe dhe plagoset një kalimtar. Dyshimet e para të policisë

25/09 09:35



SHBA-Kinë/ Trump dhe Xi diskutojnë marrëdhëniet strategjike, tregtinë dhe inteligjencën artificiale

25/09 09:15



E rëndë në SHBA/ Mësuesja dhe nxënësi i klasës së pestë humbin jetën gjatë ekskursionit shkollor

25/09 08:55

## Na ndiqni:

Top Channel | @topchannelalbania | @tchbreakingnews | Top Channel

## Video »



Top News – Vuçiç dorëhiqet pa dëbuar rusët. Presidenti serb: Do të flas me Putin për naftën



Top News – Vezë edhe në Nju Jork, Rama pritet me protestë nga një grup shqiptarësh




“Agjente serbe! Të neveris!”, Plas mes Vlora Hysenit dhe Klod Lalës! Dalim video dhe përgjime të reja



Top Channel/ Protesta e 117, organizatorët: tubim në çdo seancë parlamenti



Top Channel/ Revolta ndaj Netanyahut, braktiset salla dhe arrestohen 100 persona



Top Channel/ Alarmi i shërbimeve sekrete: Rusia do sulmojë një vend të NATO-s

**Lajme**
- Lajmet e fundit
- Politikë
- Kronikë
- Aktualitet
- Ekonomi
- Sociale
- Video
- Top News LIVE

**Bota**
- Opinion
- Koment
- Kosova dhe Rajoni
- Shkencë dhe Teknologji
- Auto

**Sport**
- Kombëtarja
- Kategoria Superiore
- Kategoria e Parë
- Premier League
- La Liga
- Serie A
- Shumësportësh
- Sport Gossip

**Pop News**
- Showbiz
- Lifestyle
- Fashion
- Shëndeti
- Dieta
- Receta gatimi

**Programe**
- Big Brother VIP
- Për'puthen
- Shqipëria LIVE
- Fiks Fare
- Video
- Të gjitha programet
- Guida TV

**Top Channel**
- Rreth Top Channel
- Kontakt
- Bileta – Portokalli
- Puno në Top Channel
- Privacy Policy & Terms of Use
- Aksesueshmëria

© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.